




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS
07Nr. _____/11
Kaçanik, 19.12. 2011



Mbështetur në nenin 83 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Rregullores për Transport Rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut 01 - Nr. 02-04-80/07, nenit 62.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike, bënë këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

PËR NDARJEN E VIJAVE TË TRANSPORTIT PUBLIK TË UDHËTARËVE NË KOMUNIKACIONIN LINJOR DHE LËSHUARJEN E LEJEVE TË PUNËS PËR OPERATOR: ME AUTOBUSË, KOMBI BUS DHE AUTO TAKSI PËR VITIN.

2012

Me këtë shpallje publike njoftohen të gjithë qytetarët e interesuar që mirren me transportin publik të udhëtarëve me autobus, kombi-bus dhe automjete me 4+1 ulëse, se mund të aplikojnë për marrjen e Lejes së punës për vitin 2012 dhe atë:

a) Për linja me autobusë, (kombi-bus në ato vija ku nuk mund të operoj autobusi), mund të aplikojnë dhe atë në:

Linjat:

Kaçanik– Kovaqec	Kaçanik - Gërlicë	Kaçanik - Kotlinë
Kaçanik– Biqec	Kaçanik –Banjicë	Kaçanik – Gllloboçicë
Kaçanik– Nikë	Kaçanik - Semajë	Kaçanik – Duraj
Kaçanik - Doganaj	Kaçanik - Stagovë	Kaçanik – Gajre
Kaçanik– Dubravë	Kaçanik–K.Vjetër	Kaçanik – Ivajë
Kaçanik - Gabricë	Kaçanik- Begracë	Kaçanik- Strazhë
Kaçanik - Elezaj		

Të interesuarit duhet që me aplikacion të dorëzojnë këto dokumente:

PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOBUSË

1. Aplikacioni,
2. Të ketë në pronësi së paku 2 autobus,
3. Të ketë të punësuar 1 punëtor (automekanik) ose kontratë me autoservisin për mirëmbajtjen e autobusëve,
4. Të ketë të regjistruar biznesin në MTI,
5. Letërnjoftimi i pronarit të autobusëve dhe shoferit me kontratë të punës (fotokopje),

6. Certifikata e mjekut, për shoferë të autobusëve.
7. Patentë shoferi për vozitësin me kategori “D” (fotokopje) e vërtetuar nga organi komunal (të ketë më tepër se dy vjet përvojë),
8. Librezat e qarkullimit për autobusët (fotokopje) të vërtetuara nga organi komunal,
9. Të mos ketë ndalesa për ushtrimin e veprimtarisë (grykata komunale),
10. Pagesa për leje pune vjetore **100 €** dhe vërtetim të rendit të udhëtimit **25 €**, paguhet më së voni gjerë 5 ditë pas dhënies së vijës, në konton e bugjetit të komunës ,
11. Të ketë të kryera obligimet komunale,
12. Rendi i Udhëtimit (orari nisjes - kthimit), të aprovuar nga drejtoria,
13. Kontratën për peronimin e autobusëve për nisje dhe kthim.

TRANSPORTI I UDHËTARËVE NË VIJAT KOMUNALE ME KOMBI

1. Aplikacioni,
2. Letërnjoftimi fotokopje,
3. Patentë shoferi fotokopje (të ketë më tepër se dy vjet përvojë),
4. Të ketë biznesin e regjistruar në MTI,
5. Të ketë në pronësi automjetin
6. Të mos ketë ndalesa për ushtrimin e veprimtarisë (Grykata komunale),
7. Rendi i Udhëtimit (orarin e nisjes- kthimit), të aprovuar nga drejtoria,
8. Taksa për leje pune **30 €** dhe vërtetimi i rendit të udhëtimit **25 €**, paguhet më së voni 5 ditë pas dhënies së lejes së punës
9. Të ketë të kryera obligimet komunale
10. Kontratën për peronim për nisje dhe kthim (kontratë njëvjeçare)
11. Çertifikatën e mjekut
12. Dëshmi për sigurimin e pasagjerëve dhe
13. dy fotografi.

OPERATORI TAKSI (Shoqëritë aksionare- kompanitë)

1. Aplikacioni,
2. Të ketë selinë në teritorin e komunës së Kaçanikut,
3. Të ketë të regjistruar biznesin në MTI,
4. Të ketë në pronësi së paku tre (3) automjete me ngjyrë të njëjtë, (dëshmi: librezat e qarkullimit për veturat – fotokopjet e vërtetuara nga organi komunal),
5. Patentë shoferë për shoferët (fotokopjet) të vërtetuara nga organi komunal,
6. Të ketë të punësuar së paku 3 shofer me përvojë më tepër se 2 vite,
7. Të ketë vend parkim, zyre, frekuenca, lidhje telefonike dhe servis për mirëmbajtje,
8. Të mos ketë ndalesa për ushtrimin e veprimtarisë (grykata komunale),
9. Të paguhet taksa në shumë prej **100 €**,
10. Të ketë të kryera obligimet komunale.
11. Certifikatën e mjekut, dhe
12. Dëshmi për sigurimin e pasagjerëve,

AUTO TAKSI (jashtë shoqatës)

1. Aplikacioni,
2. Letërnjoftimi (fotokopje),

3. Librezën e qarkullimit (fotokopje),
4. Patentë shoferi (fotokopje) të ketë më tepër se dy (2) vite përvojë,
5. Të ketë biznesin e regjistruar në MTI
6. Të mos ketë ndalesa për ushtrimin e veprimtarisë (gjykata komunale),
7. Të ketë të kryera obligimet komunale,
8. Të kryej pagesën për marrjen e LP shumë 35 € në konton e buxhetit të Komunës,
9. Certifikatën e mjekut,
10. Dëshmi për sigurimin e pasagjerëve dhe
11. dy fotografi .

Afati për paraqitjen e aplikacioneve do të jetë 15 ditë, nga dita e publikimit.

Në mungesë të dokumenteve të kërkuara, kërkesa do të refuzohet.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në arkivin e K. K të Kaçanik.

Për më shumë informacione dhe për marrjen e aplikacionit me listën e relacioneve mund t'i drejtoheni Drejtorisë për Emergjencë dhe Shërbime Publike zyra nr. 33.

Vërejtje: Të gjithë operatorët në vija të rregullta të Transportit Publik të Udhëtarëve, me: Autobus dhe Kombi - Bus, krahas dokumentacionit të lartcekur, duhet ta paraqesin edhe çmimet e muajoreve dhe biletave, sipas Rendit të Udhëtimit, pasi që; çmimet e paraqitura sipas juve, do të vërtetohen edhe nga drejtoria përkatëse.

Kaçanik, 19.12.2011

Drejtore i Drejtorisë;
z. Rushan Ceka